



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 1123 Prot

Gjirokastrë më, 01 : 02 : 2026

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 28.01.2026

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës. 28.01.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më 28.01.2026 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet pranë UNED-it. Mbledhja fillon në orën 12:05.

Marrin pjesë në mbledhje 17 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Mahmutaj, Novi, Rova, Shehaj, Drasa, Leskaj, Peta. Qeli. Cacaj, Pandos, Kristidhi, Feruni, Manjola Shehaj. Online është znj. Kondi.

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj hap mbledhjen dhe lexon rendin e ditës duke njoftuar këshilltarët se pika 8 e rendit të ditës është hequr nga rend i ditës është tërhequr nga ekzekutivi me anë të shkresës me nr 902 /prot në datë 27.01.2026 për arsye se gjatë verifikimeve përfundimtare të dokumentacionit kadastral u konstatua mospërputhje në numrat e pasurive dhe të dhënat kadastrale lidhur me pasurinë objekt transferimi.

Gjithashtu paraqitet edhe pika shtesë P/Vendim” Për një ndryshim në vendimin Nr. 1, datë 13.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë me qëllim përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga përmbytjet e datës 06.01.2026 në Bashkinë Gjirokastrë”. Znj. Isaraj hedh në votë rendin e ditës, i cili miratohet me 17 vota pro me heqjen e pikës 8 dhe pikën shtesë të propozuar nga ekzekutivi.

1. Miratim i procesverbaleve të mbledhjes së datës 22.12.2025 dhe të mbledhjes jashtë radhe të datës 13.01.2026.

2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01.01.2026-31.01. 2026”.

3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01.01.2026-31.01. 2026

4. P/Vendim për një shtesë në VKB nr.101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”.

5. P/Vendim “Për miratimin e listës së parcelave kullosore verore/dimërore që do të kontraktohen për përdorim me qira për kullotje për sezonin veror 2026 dhe sezonin dimëror 2026-2027”.

6. P/Vendim “Për një shtesë në VKB nr.101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”, për projektin CERV DHE CROSS”.

7.P/Vendim “Për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit me objekt “Ndërtimii BYPASS-it në Qendrën Historike (“Ura e Nanxës”- “Urat e Mëdha Dunavat).

8. P/Vendim” Për një ndryshim në vendimin Nr. 1, datë 13.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë me qëllim përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga përmbytjet e datës 06.01.2026 në Bashkinë Gjirokastrë”.

9.Trajtim i kërkesave të qytetarëve.

Hidhen në vote dhe miratohen me 17vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 22.12.2025 dhe të mbledhjes jashtë radhe të datës 13.01.2026.

Hidhen në vote dhe miratohet me 17 vota pro P/Vendimet e ndihmës ekonomike, pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës.

P/Vendim“Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01.01.2026-31.01. 2026”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01.01.2026-31.01. 2026”.

Znj. Isarajl exon pikën 4 të rendit të ditës.

ZNJ. Lapaj. pikat 4 dhe 6 kanë kaluar dhe janë miratuar dje në mbledhjen e Komisionit të Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik.

Kërkohet sqarim nga ekzekutivi.

ZNJ. Koko sqaron se këto dy projekte kanë të bëjnë me një qasje të integruar ndaj menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore duke kombinuar inovacionin digjital, përfshirjen e komunitetit dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe me promovon shkëmbimet ndërmjet njerëzve nga vende, kultura, gjini dhe prejardhje të ndryshme socio-ekonomike, forcon mirëkuptimin dhe tolerancën reciproke dhe u jep atyre mundësinë të zgjerojnë këndvështrimin e tyre dhe të zhvillojnë një ndjenjë përkatësie dhe identiteti evropian përmes projekteve “Binjakëzimi i Qyteteve “

Z. Brahimi: Të rregullohet te relacioni termi Joanina sepse ne gjuhën shqipe thuhet dhe shkruhet Janina.

Znj. Isaraj;Është gabim teknik, do të rregullohet në material, nuk besoj se është bërë qëllimisht.

Z. Dashnor Aliko; Vetëm nga bashkia është apo është grant?

Znj.Koko: Sot jemi në fazën e kalimit në parim, më pas vazhdoen hapat me tej pas konfirmimit nga Ministria e Jashtme.

Z. Dashnor Aliko:Menaxhimi bëhet nga bashkia apo nga zyra?

ZNJ. Koko Projektet fillojnë nga Zyra e Integritimit Evropian pranë Bashkisë,në Ministrinë e Jashtme, donatori dhe financa është hallka e fundit.

Hidhet në votë dhe miratohet me17 vota pro: Pika 4: P/Vendim për një shtesë në VKB nr.101, datë 22.12.2025“Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe BuxhetitVjetor2026 Kalohet e pika 5.

Z. Brahimi ngre shqetësimin në përditësimin e materialit dhe të hiqet nga materiali lista e kullotave që janë hequr vitin e kaluar, nuk mund të sillen po njësoj.

Z. Nebiaj; Do ta rishohim materialin dhe nëse janë hequr nga lista nuk do të jenë pjesë e materialit.Ne heqim nga lista rast pas rasti ato pasuri që u jane kthyer ish probarëve me VKM, dhe është procedurë kalimi i tyre me vendim të Këshillit Bashkiak.

Miratohet me 17 vota pro pika 5. P/ Vendim "Për miratimin e listës së parcelave kullosore verore/dimërore që do të kontraktohen për përdorim me qira për kullotje për sezonin veror 2026 dhe sezonin dimëror 2026-2027" duke hequr nga lista parcelat që u janë kthyer ish pronarëve deri në vitin 2024-2025.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro pika 6 e rendit të ditës P/Vendim "Për një shtesë në VKB nr.101, datë 22.12.2025 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026", për projektin CERV DHE CROSS".

Kalohet e pika 7. P/Vendim "Për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit me objekt "Ndërtimii BYPASS-it në Qendrën Historike ("Ura e Nanxës"- "Urat e Mëdha Dunavat)".

ZNJ. Orgesa Haska: Kjo pikë ka kaluar dje në komision. Çdo gjë është konform ligjit, dosja është e plotë me të gjithë elementët e saj.

Z. Aliko: Pse është sjellë kaq vonë? Punimet janë bërë më shpejt.

z. Nebiaj. Pronar i objektit e ka çertifikuar tani vonë dhe vonesa nuk kardhur nga ne.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro P/Vendim "Për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit me objekt "Ndërtimii BYPASS-it në Qendrën Historike ("Ura e Nanxës"- "Urat e Mëdha Dunavat)".

Kalohet më tej te pika shtesë "Për një ndryshim në vendimin Nr. 1, datë 13.01.2026 "Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë me qëllim përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga përmbytjet e datës 06.01.2026 në Bashkinë Gjirokastrë".

Z. Aliko: Meqë jemi në kuadër të emergjencave të mbikalimi i tankut të përroi në Lazarat është gërryer nga poshtë nga ujërat dhe nëse nuk ndërhyet tani me pak lekë, po u rrëzua do të duhen 50 milion lekë.

Z. Muho. Janë bërë shumë dëme dhe ende nuk janë krijuar komisionet e verifikimit në terren.

ZNJ. Lelaj: Janë ngritur grupet e punës dhe deri tani janë bërë 120 verifikime në terren.

ZNJ. Ana Kotro. Në lagjen "Varrosh" nuk kanë ardhur grupet e emergjencave, nu ki kanë parë problemet dhe rruga është në gjendje shumë të keqe pas problemeve me shiun.

Z. Aliko: Përroi i "Ficos" është lejuar për parkime, janë mbushur tre pritrat kryesore dhe është rrezik për banesat.

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro pika shtesë. "Për një ndryshim në vendimin Nr. 1, datë 13.01.2026 "Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë me qëllim përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga përmbytjet e datës 06.01.2026 në Bashkinë Gjirokastrë.

Në pikën të ndryshme z. Petrit Brahimi kërkon zhvillimin e një mbledhjeje për evidentimin e ndërtesave që nuk funksionojnë më në shërbim të institucioneve me qëllim fillimin e procedurave kalimin e tyre në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë për kryerjen e detyrave të saj funksionale.

Mbyllet mbledhja nga znj. Isaraj.

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo



KRTETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ

